



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/343
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101574/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Lezhë.

Drejtuar: Drejtues i Parë Luan HYSENJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë

LEZHË

Kryekomisar Ermal AJDINI
Shef i Komisarariatit të Policisë Lezhë

LEZHË

Për dijani: Drejtues Madhor Gledis NANO
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve, zhvilloi një inspektim në Komisariatin e Policisë Lezhë.

Inspektimi u krye në datën 24.11.2020, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", në Procedurën Standarde "Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, në Procedurën Standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me shefin e rendit z. Agron Çuhaj, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i rendit informoi grupin e inspektimit për gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë në këtë komisariat, trajtimi i personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm, vijoi takimin me punonjësit e policisë të zyrës së informacionit dhe të shërbimit në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, inspektoi ambientet ku privohet liria e personit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e policisë të Komisarariatit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që zhvilloi grupi i inspektimit në ambientet e këtij Komisaritati.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 29.06.2020, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të shoqëruarit dhe të ndaluar/arrestuarit, rezultoi:

1. Ishte zbatuar rekomandimi për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në mjedisin dhe korridorin e ambientit të shoqërimit.
2. Ishte zbatuar rekomandimi për vendosjen në dhomat e shoqërimit të posterave me të drejtat e personave të shoqëruar në organet e policisë, me qëllim që ato të jenë të aksesueshme nga këta persona.
3. Ishte zbatuar rekomandimi për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, në lidhje me rekomandimet e CPT-së në raportin e botuar në 17 Shtator 2019 për Shqipërinë, si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për ndërgjegjësimin e stafit të punonjësve të policisë të këtij komisaritati, për zbatimin e masave të parashikuara në protokollin shëndetësor në mbajtjen e maskave mbrojtëse, përdorimin e disinfektantëve dhe ruajtjen e distancimit fizik dhe social, për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kriterëve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të

arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e vendit bosh të organikës së DPV Lezhë me mjek me kohë të plotë ose me kontratë me kohë të pjesshme, me qëllim garantimin e shërbimit mjekësor sipas standardeve të personave të arrestuar/ndaluar në këtë komisariat.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për reduktimin e mbipopullimit të personave në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë, deri në shtimin e dhomave të sigurisë.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomave/ambienteve të intervistimit në këtë komisariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, për plotësimin në kohë e me përgjegjësi të regjistrimit të kërkesë/ankesave të shtetasve, për të bërë sa më efektiv sistemin e kërkesë/ankesave.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e pajisjeve elektrike për ngrohje në periudhën e dimrit të ambientit të shoqërimit.

Për shkak të situatës të krijuar nga pandemia COVID-19, grupi inspektimit kontrolloi gjithashtu, se çfarë masash ishin marrë për parandalimin e përhapjes së virusit, sigurimin e maskave mbrojtëse dhe disifektantëve për stafin, por dhe për qytetarët që marrin shërbime në mjediset e policisë, zbatimin e protokollit shëndetësor për ruajtjen e distancimit social dhe fizik të punonjësive të policisë të kontaktuar me njëri-tjetrin dhe me qytetarët, si dhe vendosjen e postrave në vende të dukshme me rregullat që duhet të ndiqen për parandalimin e saj. Këto rregulla ishin zbatuar kryesisht në mbajtjen e maskës në ambientet e punës. Disifektantët për pastrimin e duarve, ishin vendosur në vende të dukshme në ambientet e shoqërimit, ishin afishuar materiale informuese për zbatimin e protokollit shëndetësor për parandalimin e kësaj sëmundje, për ruajtjen e distancës fizike mes njëri-tjetrit dhe me qytetarët, etj.

Ambientet e brendshme dhe të jashtme të institucionit, disinfektoheshin çdo muaj sipas grafikut të hartuar nga DVP Lezhë. Aktualisht nuk kishte asnjë anëtar stafi të infektuar me COVID-19. Në kuadër të vaksinimit vullnetar, stafi i punonjësve të administratës dhe të policisë së institucionit, ishin vaksinuar të gjithë me dy doza.

Në përfundim, grupi i inspektimit konstatoi se, në Komisariatin e Policisë Lezhë ishin marrë masa për përmirësimin e standardeve lidhur me garantimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, por vazhdonin të ishin të pranishme edhe disa problematika, të cilat po i parashtrajme më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Lezhë, mjedisi i shoqërimit në tërësi ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, duke krijuar dhoma shoqërimi të ndara më vete për femra, personat e rritur dhe të miturit.¹

Në këtë Komisarlat, ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës kryesore. Ai përbëhej nga 3(tre) dhoma shoqërimi, të ndara më vete për gra, personat e rritur dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit kishin hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme dhe ishin të pajisura me tavolina, karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 5x3m² dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë. Sipas informacionit të dhënë kapacitetet në këto ambiente ishte deri në 12 shtetas të shoqëruar për konflikt me ligjin.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin të siguruara me skarë hekuri në pjesën e jashtme, me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise. Dritaret ishin me përmasa të tilla që krijojnë mundësinë e ajrimit dhe ndriçimit të plotë natyral. Në dhoma kishte edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Ambienti i shoqërimit ishte i lyster dhe i disinfektuar, por në momentin e inspektimit ai **nuk** ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare. Brenda në dhomat e shoqërimit ndodheshin tualete për meshkuj, ashtu dhe për femra. Këto ambiente ishin të pajisura me materialet e duhura hidrosanitare dhe kishin ujë të rrjedhshëm në 24 orë por mungonin bolierët për ngrohjen e ujit, i cili është i domosdoshëm për mbajtjen pastër të higjienës së personave të shoqëruar në këtë institucion.

Në mjedisin e shoqërimit ndodhej një ambient me dhomë dhe paradhomë për kryerjen e “përgjimit ambiental dhe njohje me persona nën hetime penale për veprime procedurale të bërë” nga punonjësi i policisë sikurse parashikohet në ligj, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga organi i prokurorisë.²

Nga inspektimi i ambienteve të dhomave të shoqërimit, u konstatua se gjendja teknike e godinës ishte e mirë por kishte prezencë të lagështirës. Dhomat e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Lezhë edhe pse ishin të lyster, në vende të caktuara, kishte rënë suvaja për shkak të lagështirës që ishte prezente. Ky shqetësim, u evidentua edhe nga drejtuesit e komisarlatit, lagështira ishte evidente në gjithë katin e parë të godinës së komisarlatit, por më e theksuar ishte në ambientin e tualeteve. Niveli i lagështirës ishte tej normave të pranushme, dhe si pasojë ka ndikim negativ në jetën dhe shëndetin e personave të shoqëruar, ndaluar/arrrestuar, si dhe për vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Gjatë inspektimit, u evidentua se ishte krijuar një mjedis i ri i quajtur “Hapësirë miqësore për fëmijët”, që shërbente për intervistimin apo marrjen në pyetje të personave të mitur në konflikt me ligjin. Ky ambient, përbëhej nga 3 dhoma të kompletuara me paisje dhe orenditë e nevojshme për mbrojtjen dhe trajtimin dinjitoz të të miturit, viktimë e një vepre penale, gjatë procesit të hetimit. Ky investim, kishte 1 vit që ishte venë në funksionim dhe

¹ Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”

² Neni 131, pika1/a i ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, ndryshuar

ishite financuar nga organizata “Eorld Vision” në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Korridori i dhomave të shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Lezhë, ishte e survejuar nga sistemi i kamerave përgjatë 24 orëve.

Në Komisaritati e Policisë Lezhë, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 24.11.2021 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evindetuar në rregjistrin e shoqërimit **886** persona, ku saktësisht **851** shtetas madhor, **15** shtetas të mitur dhe **20** shtetase gra të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit. Në momentin e inspektimit, **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e Komisarariatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, marrjes në pyetje apo intervistimin e tyre.

Gjatë inspektimit, u evidentua gjithashtu se në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, me qëllim që këto të drejta të njihen dhe të jenë të aksesueshme nga personat e shoqëruar.

Nga inspektimi u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisarariatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Grupi i inspektimit nuk konstatoi në ambientin e shoqërimit, sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjior për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administrates publike, ka filluar trajtimin me iniciativë të problematikave dhe shqetësimeve që kanë lindur gjatë dhe pas protestës së ndërmarrë nga një numër individësh në afersi të Thines/Mirdite, në mbështetje të një çështjeje për mbrojtjen e ambientit për shkak të ndërhyrjeve që janë ndërmarrë në kuadër të ndërtimit të një hidrocentrali.

Në përfundim të shqyrtimit të tyre, në disa raste nga Avokati i Popullit është konstatuar se kjo e drejtë nuk respektohet gjithmonë nga organet e Policisë së Shtetit në përputhje me standardet ndërkombëtare apo frymën e ligjit vendas. Këto të fundit jo vetem që nuk kanë kontribuar në realizimin e saj, por ndonjëherë janë bërë edhe pengesë duke e cenuar këtë të drejtë themelore kushtetuese të shtetasve. Për këto arsye në vijimësi janë bërë disa rekomandime organeve të Policisë së Shtetit³

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

³ Dërguar rekomandimi Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. K2/I25-2 prot., datë 17.05.2021 “Për marrjen e masave ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë për mohimin e të drejtës së mbrojtjes për protestuesit e Thirrës, si një standard i parashikuar dhe garantuar nga neni 6, 5 dhe 3 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në Komisariatin e Policisë Lezhë, ambienti i sigurisë ishte i ndërtuar në tërësi sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e Procedurave Standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.

Ambientet e sigurisë përbëheshin nga 4 dhoma sigurie me kapacitet zyrtar për 6 persona. Konkretisht 2 dhoma me nga një person secila ndërsa 2 dhoma të tjera me 2 persona, të ndara në dhoma për të rritur, në dhoma për femra dhe në dhoma për të mitur, sipas kërkesës së ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde: *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesave të tyre”*, miratuar me urdhrin nr.925, datë 18.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodheshin 8 (tetë) persona, në cilësinë e të arrestuarit dhe të ndaluarit.

Kapaciteti maksimal i institucionit është 8 persona duke shtuar krevat shtesë. Në ditën e inspektimit grupi i monitorimit konstatoi se ndodheshin **8 persona të ndaluar/arrestuar**. Pra, institucioni kishte **2 persona** mbi kapacitetin fizik dhe për pasojë kjo situatë mbipopulli kishte ndikuar në përkeqësimin e kushteve të jetesës të të ndaluar/arrestuar në dhomat e banimit ku ishin akomoduar 1 deri 3 persona. Kjo situatë e mbipopullimit, kishte cënuar parametrat e nevojshëm të hapësirës dhe sipërfaqes jetike për një person në dhomat e banimit. Shkelja e këtyre standardeve bazike për jetesë, përbën trajtim jo dinjitoz të personave që vuajnë dënimin në kushtet e këtij institucioni.

Gjithashtu, grupi i inspektimit verifikoi regjistrin për evidentimin e të dhënave të personave të arrestuar/ndaluar, për periudhën e inspektimit, ku u konstatuan disa raste të mbipopullimit në dhomat e sigurisë. Kjo për shkak të fluksit të madh të personave të ndaluar apo arrestuar nga komisaritet e policisë së Lezhës, Mirditës dhe Kurbinit, si dhe numrit të vogël të dhomave të sigurisë. Në rastet e mbipopullimit, personat mbi kapacitetin zyrtar të dhomave të sigurisë, shtriheshin me dyshekë në dysheme. Kjo situatë e mbipopullimit, përbën trajtim çnjerëzor të personave të ndaluar/arrestuar, ndaj është e nevojshme të merren masa të menjëhershme teknike dhe organizative nga drejtuesit e policisë në DVP Lezhë, për shtimin e dhomave të sigurisë dhe reduktimin e rasteve të mbipopullimit.

Ambientet e dhomave të sigurisë ndahen në dy pjesë, në ambientin për jetesë dhe në paradhomën që shërbente për qëndrimin e personave në orare të caktuara dhe për pastrim vetjak, pasi ndodhej çezma me lavaman. Dy prej dhomave ishin të pajisura me nga dy shtretër me krevatë dhe dy të tjera me nga një shtrat me krevat.

Dhomat e sigurisë për femra dhe të mitur i plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 m², e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².

Ndërsa dy dhomat për të arrestuarit/ndaluarit meshkuj madhorë, ndonëse ishin të ndara në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m², **nuk** plotësonin kriteret për sipërfaqen e nevojshme për jetesë për dy persona⁴.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla, që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Çdo dhomë ishte e pajisur me tualete brenda dhe me orënditë e nevojshme për jetesë si krevat, dyshekë, batanije dhe jastëk, të cilat ishin në gjendje të mirë dhe të pastra.

Të ndaluarit/arrestuarit kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në paradhomë, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (1 dush me ujë të ngrohtë), i cili ndodhej në korridor. Dushet ishin funksionale dhe punonin me sistem qëndror, po ashtu në paradhomën e dusheve kishte dhe tualet të përbashkët, i cili ishte i pajisur me të gjitha pajisjet që shërben për këtë qëllim.

Larja e batanijeve dhe ndërrimi i materialeve të vjetëruara apo dëmtuara që shërbenin për fjetje në dhomat e sigurisë, kryhej periodikisht sipas një grafiku të miratuar nga struktura përgjegjëse në drejtorinë e policisë Lezhë.

Në ambientet e sigurisë **nuk** kishte sistem ngrohjeje/ftohje me sistem qëndrore sipas kushteve klimaterike, sikurse parashikohet edhe në procedurat standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, por për periudhën e dimrit institucioni kishte siguruar pajisje elektrike, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në çdo dhomë kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevojë. Në korridorin e ambientit të sigurisë kishte aparat telefonik fiks dhe citofon për përdorim nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Ambienti i sigurisë kishte burim rezervë energjie me gjenerator më vete.

Ambienti i sigurisë kishte një dhomë për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku/ndihmësmjeku, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige. Por, në këtë komisariat, vazhdonte të ishte shqetësuese mungesa e mjekut të punësuar me kohë të plotë. Sipas informacionit të drejtuesve të komisariatit, mjeku është me kohë të pjesshme në institucion.

Mungesa e mjekut/ndihmësmjekut me kohë të plotë Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Lezhë, është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara në ligj dhe në procedurën standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar, si dhe aktet ndërkombëtare, të cilat përcaktojnë qartë kryerjen e detyrueshme të vizitës mjeksore brenda afatit 12 orë, nga koha e hyrjes të personave të ndaluar/arrestuar në ambientin e sigurisë. Kryerja e vizitave mjeksore dhe evidentimi i tyre në kartelë dhe regjistrin përkatës të komisariatit të policisë⁵, janë detyrim ligjor për mjekun/ndihmësmjekun, por dhe për drejtuesit dhe punonjësit e policisë, pasi duhet të garantojnë shërbimin shëndetësor të nevojshëm ndaj këtyre personave, gjatë gjithë periudhës që ata ndodhen në mjediset e policisë. Njëkohësisht, kartela mjeksore individuale, ku pasqyrohen dinamika e vizitave

⁴ Kreu V, pika 3.3 e *Procedurave Standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre"*

⁵ Kreu II, pika 7, e *Procedurave Standarde*

mjekstore dhe mjekimet e kryera, janë dokumente të rëndësishme pasi ato shoqërojnë më tej personin në të gjitha institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit. Duke qenë se Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë ka fluks të madh të personave të ndaluar apo arrestuar nga komisariatet e policisë së Lezhës, Mirditës dhe Kurbinit, është e domosdoshme që mjeku të jetë kohë të plotë në këtë institucion. Fakti që mjeku punonte me kohë të pjesshme dhe është i pranishëm në këtë institucion vetëm pjesërisht gjatë ditës, përbën cenim të standardeve të kujdesit shëndetësor. *“Derisa qëndrojnë në dhoma e privimit të lirisë, personave të ndaluar/arrestuar duhet t’u mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Mekanizmi Kombëtar konstaton në mënyrë përsëritur se mungesa e mjekut me kohë të plotë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente dhe si rrjedhojë pasojat mund të jenë të rënda.

Në ambientin e sigurisë ndodhej edhe një dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët privatë, e cila shërbente njëkohësisht edhe për marrjen në pyetje të këtyre personave nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave, por brenda saj **nuk** ishte instaluar sistemi audio-viziv për vëzhgim veprimet e policisë me personat e ndaluar/arrestuar, si dhe për të parandaluar çdo kundërveprim të tyre ndaj punonjësve të policisë.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me sistemin e kamerave përgjatë 24 orëve.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në zbatim të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.938, datë 24.07.2019, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi e sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera, edhe me regjistrat përkatës. Nga inspektimi rezultoi se, regjistrat ishin të mbajtur në rregull, ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë, Lezhë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” konform me procedurat standarde për rregullat teknike të shoqërimit në polici dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqytja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.⁶

⁶ Kreu VII, procedurat standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin Nr.938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në këtë Komisarjat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e arrestimeve dhe ndalimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën që në momentin e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë.

Avokati i Popullit, duke marrë shkas nga trajtimi i ankesave individuale, rasteve me iniciativë, si dhe nga inspektimet e kryera për këqyrjen e regjistrave që administrohen nga organet e Policisë së Shtetit, ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose i ndalimit, duhet të vihet ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimi/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij, por edhe në nenin 109, pika 4 e ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Nga inspektimi, u konstatua se në këtë komisarjat kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi dhe këqyrja e këtij regjistri u evidentuan më së shumti kërkesa për avokat dhe për vizita mjekësore për Spitalin Rajonal Lezhë.

Avokati i Popullit ka tërhequr vemendjen e autoriteteve ligjzbatuese që në ushtrtimin e detyres të regjistroj çdo kërkesë apo ankesë të çdo personi, shoqëruar ndaluar/arrestuar në institucionet e privimit të lirisë. Qëllimi i ankesa/kërkesa s'mund të jetë heshtja e mos dëgjimit të zërit të personit por siguri, shëndet dhe garanci e jetës të personit në vendet e privimit të lirisë.

Në Komisarjatin e Policisë Lezhë, u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin ose prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore regjistër për të mitur në konflikt me ligjin, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes, si dhe karta me të drejtat e personave të ndaluar ose të arrestuar në gjuhën shqipe dhe në 8 gjuhë të huaja, të cilat mbaheshin në dhomën e punës dhe administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Avokati i Popullit në rekomandimi e parë⁷ konstaton se një nga shqetësimet kryesore dhe thelbësore të parashtruara nga protestuesit dhe perfaqësuesit e tyre ligjore, ishte edhe mungesa e kontakteve dhe e garantimit të ndihmes ligjore që në momentet e para të shoqërimit të një numri shumë të lartë e protestuesve në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.

⁷ Dërguar rekomandimi Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nr. K2/I25-2 prot., datë 17.05.2021 “Për marrjen e masave ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë për mohimin e të drejtës së mbrojtjes për protestuesit e Thirrës, si një standard i parashikuar dhe garantuar nga neni 6, 5 dhe 3 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Lezhë nuk kishte asnjë person të shoqëruar, ndërsa në dhomat e sigurisë ndodheshin 8 (tetë) persona të arrestuar/ndaluar.

Nga intervistat që zhvilloi grupi i inspektimit me personat e ndaluar/arrestuar, u konstatua se ata ishin trajtuar në mënyrë korrekte nga punonjësit e shërbimit të dhomave të sigurisë, si dhe gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Dhomat e sigurisë **nuk** plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më shumë se 10 metra katrorë, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Institucioni i Avokatit Popullit çmon se situata e mbipopullimit ka bërë që të akomodohen në përgjithësi 1 deri 3 persona në dhomë, dhe e konsideron si një problematikë të qënësishme, duke pasur parasysh kapacitetet e lejuara për akomodimin për të ndaluar/arrestuar në këtë institucion. Nga vlerësimi i kushteve materiale të institucionit, ato nuk janë sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Ata nuk trajtoheshin në mënyrë denigruese apo jo humane, si dhe ndaj tyre nuk ushtrohej dhune fizike e psikologjike, me përjashtim të rastit të 2(dy) personave, që flinte me dyshekë të vendosur në dysheme.

Nga intervistat me personat e ndaluar/arrestuar dhe informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshëm dhe Ministrisë të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej dhe shërbehej nga një subjekt privat që ushtronte aktivitetin brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Lezhë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin, u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarve/arrestuarve iu ishin dhënë produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Ambientet e intervistimit

Në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takim me avokatët. Kjo dhomë nuk ishte e monitoruar nga sistemi i kamerave.

Shtetasit e shoqëruar, para se të ndaloheshin apo arrestoheshin dhe të futeshin në ambientet e sigurisë, intervistoheshin nga oficerët e policisë gjyqësore në zyrat e punës së këtyre të fundit. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte

ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Sa më sipër, kjo situatë e pazgjidhur vjen në kundërshtim me pikën 6 kreu XIV *Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, ndër të tjerat përcakton se: Në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuareve/ndaluarve për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit.

Avokati i Popullit e konsideron përdorimin e dhomës së intervistimit dhe procesin e monitorimit filmik në të, si një element parësor dhe një standard ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre.⁸

Nga monitorimi që iu bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore në kohën e inspektimit, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Në këtë komisarjat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr. Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të cilat u verifikuan gjatë intervistimit të personave të ndaluar/arrestuar nga grupi i inspektimit.

Gjatë inspektimit, rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga ana e punonjësit të policisë mbahej edhe një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

Gjithashtu nga mbikëqyrja e fashikullit të dosjes për persona të shoqëruar ndaluar/arrestuar, u konstatua se, zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, duke krijuar mundësinë për të kontaktuar me të. Koha më e zgjatur në marrjen kontakt të personit të privimit lirisë me avokatin ishte afërsisht 3 orë.

⁸ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të rregjistrohen në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë dhe kishte detyrimin të asistonte të miturin deri në përfundim të procedurave përkatëse.

Grupi inspektimit u evidentoi mungesa e mjekut me kohë të plotë në këtë institucion. Ky është një problem thelbësor veçanërisht në kohën aktuale të pandemisë. Nga informacioni i marrë nga shefi i rendit, u informuam se shërbimet shëndetësore për personat e ndaluar/arrestuar kryhen nga mjeku i emëruar me kohë të pjesshme në këtë institucion, i cili vinte çdo ditë nga ora 13:00 16:00, si dhe për raste urgjente të ndaluarit/arrestuarit dërgohen në Spitalin Rajonal Lezhë.

Mekanizmi Kombëtar konstaton se mungesa e mjekut në këtë institucion ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, me një mjek me kohë të plotë, pasi mund të ketë raste urgjente dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Grupi i monitorimit konstatoi se, vizitat mjekësore nga ana e mjekut kryheshin brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”⁹

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarjatin e Policisë Lezhë ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar. Ato ishin të vendosur në korridoret e këtyre ambienteve, dhe ishin të afishuara dhe në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, me qëllim që ato të jenë të aksesueshme nga këta persona.

Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur posterat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve, e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre.

⁹ Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.

Nga rradhët e punonjësve të policisë të këtij komisariati, ishin trajnuar dhe specializuar 3 punonjës policie që administronin dhe asistonin procesin e drejtësisë penale për të mitur.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëherëshme për eliminimin e lagështirës në ambientet e dhomave të shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Lezhë.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar shtimin e dhomave të sigurisë me qëllim respektimin e kriterëve të hapësirës së nevojshme për jetesë për çdo person të arrestuar/ndaluar, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.
3. Marrjen e masave të menjëherëshme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, sipas parashikimeve në organikën e Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë.
4. Marrjen e masave të menjëherëshme nga ana e stafit të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, për t’iu përgjigjur në kohë kërkesave të të shoqëruarëve, ndaluar/arrestuar, në lidhje me vizitat mjekësore, si dhe konsultat e specializuara në Spitalin Rajonal Lezhë.
5. Marrjen e masave të menjëherëshme, për reduktimin e mbipopullimit të personave në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë, deri në shtimin e dhomave të sigurisë.
6. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e dhomave/ambienteve të intervistimit në këtë komisarariat ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto ambiente.
7. Marrjen e masave të menjëherëshme për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e paisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, ndalimit/arrestimit për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

8. Marrjen e masave për mirëmbajtjen e garantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë së tualetit dhe të ambienteve të Komisarariatit të Policisë Lezhë, si dhe lyrjen dhe dezinfektimin e vazhdueshëm të tyre.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e tualeteve të dhomave të shoqërimit me bolier për ngrohjen e ujit për të qenë sa më funksionale për persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë Lezhë.
10. Marrjen e masave të menjëhershme për trajnimin e stafit të punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë, për plotësimin në kohë e me përgjegjësi të regjistrit të kërkesë/ankesave të shtetasve, për të bërë sa më efektiv sistemin e kërkesë/ankesave.
11. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë.¹⁰
12. Marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtës ligjore për tu takuar e mbrojtur me avokat shtetasve të arrestuar/ndaluar në organet e Policisë së Shtetit që në momentet e para të shoqërimit të tyre.
13. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisarariat.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA

¹⁰ Kreu VII, pika 4/d Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.